

Raport Mujor për fondin Credins Premium

Fondi Credins Premium ka objektiv të maksimizojë të ardhurat tuaja, duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Portofoli i Fondit CREDINS PREMIUM, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Data e raportit: 31.08.2021

Informacion për Fondin

Shoqëria Menaxhuese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Korrik 2016
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi CREDINS PREMIUM ka një profil rreziku në nivelin 2, pra të ulët.

Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	3,514,791,485.13
Cmimi i kuotës	1,348.2402
Kohëzgjatja e Modifikuar	3.68 vjet
Kthimi nga investimi (31.08.2020 - 31.08.2021)*	3.62 %

* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rishmimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i rishmimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asete janë të emetuara nga Qeveria agjensitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

*Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Premium.

Kostot dhe Pagesat


Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

Tarifa e hyrjes apo daljes	0%
Tarifa e administrimit	1% në vit e VNA të Fondit
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	0 Lekë
Kosto të tjera:	
Kosto të transaksioneve për investimin e asetëve të fondit	sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese
Tarifa e auditimit vjetor të fondit	sipas kushteve të punës së kompanisë së auditit
Tarifa e depozitarit	0.1836% në vit e VNA
Tarifa e AMF	0.05% në vit e VNA

Shpërndarja e Instrumentave si përqindje e Aseteve Totale të Fondit

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Aseteve
Obligacione	3,093,576,083.51	87.7%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	432,897,552.93	12.3%


Shpërndarja e Instrumentave sipas Llojit



Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit


Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, ankandet për bonot e thesarit me afat 3-mujor dhe 6-mujor organizohen një herë në muaj, ndërsa ato 12-mujore organizohen çdo dy javë. Duke përfshirë ankandet e obligacioneve 2-vjeçare, të cilat zhvillohen një herë në muaj, ankandet e obligacioneve të tjera (3,5,7,10-vjeçare) zhvillohen me një frekuencë të përafërt prej 3 muajsh.

Ecuria e yield-eve të Bonove 3, 6 dhe 12-mujore



Rezultati i ankandit të datës 17 gusht i bonos 3-mujore rezultoi me ulje nga 0.991% në 0.865%. Gjatë muajit gusht u zhvilluan dy ankande për bono 6-mujore. Rezultati i ankandit të datës 3 gusht shënoi ulje nga 1.246% në 1.221%, ndërkohë që rezultati i datës 31 gusht për bonon 6-mujore shënoi rritje në 1.336%. Gjatë muajit gusht u zhvilluan tre ankande për bono 12-mujore. Në rezultatit e ankandit të datës 3 gusht, bono 12-mujore u rrit nga 1.511% në 1.62%. Në rezultatit e ankandit të datës 17 gusht, bono 12-mujore shënoi rritje të mëtejshme në 1.844%, ndërkohë që rezultati i ankandit të datës 31 gusht shënoi rënie në 1.768%.

Ecuria e yield-eve të Obligacioneve



Rezultati i ankandit për obligacionin referencë 3-vjeçar rihapje në datë 23 gusht shënoi rritje nga 2.443% në qershor në 2.62%. Gjatë muajit gusht nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 2-vjeçare, 5-vjeçare, 7-vjeçare dhe 10-vjeçare.

Kthimi vjetor neto historik

Asetet e Fondit janë të gjitha të investuara në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe si rrjedhojë ecuria e normës së kthimit të Fondit ndikohet nga lëvizja e normave të interesit në ankandet e titujve të Qeverisë Shqiptare.

Fondi është i detyruar të regjistrojë obligacionet dhe bonot në portofol sipas vlerës së drejtë, që do të thotë kryen vlerësimin e tyre të tregut çdo ditë. Çmimi i obligacioneve dhe i bonove ka një relatë të zhdrejtë me normat e interesit. Kur normat e interesit në treg rriten, çmimi (vlera) e obligacioneve dhe bonove të mëparshme ulet dhe për rrjedhojë ulet dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen.

Kthimet neto të Fondit nga themelimi deri më 31 gusht 2021 sipas periudhave të ndryshme janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Periudha e qendrimit	Kthimi vjetor periudhës
1 vjeçare	3.62% në vit
2 vjeçare	3.16% në vit
3 vjeçare	4.35% në vit
4 vite	4.69% në vit
Që nga themelimi	5.31% në vit

Pandemia shëndetësore e shkaktuar nga përhapja e virusit COVID-19 ka impaktuar situatën ekonomike në vend, duke rritur kërkesat dhe kostot e borxhit për Qeverinë Shqiptare. Si pasojë, gjatë vitit 2020 është vërejtur një rritje e luhatshmërisë së normave të obligacioneve qeveritare, të cilat kanë impaktuar negativisht normën e kthimit të Fondit për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019.


Duke konsideruar situatën ekonomike, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në treg duke marrë masa për lehtësimin e nevojave për kapital si dhe duke ulur kostot e likuiditetit të cilat së bashku me ri-fillimin e aktivitetit ekonomik në vend pritet të sjellin stabilizim të normave.

Masat e marra nga Banka e Shqipërisë:

- ✓ Ulje e normës bazë të interesit, nga 1.0% në 0.5%;
- ✓ Ulje normës e interesit të kredisë njëditore, nga 1.9% në 0.9%;
- ✓ Mbajtje e pandryshuar e normës së interesit të depozitës njëditore, në nivelin 0.1%.
- ✓ Injektivim i likuiditetit nëpërmjet ndryshimit të formës së ankandeve

Përmirësimi i financave të Qeverisë Shqiptare gjatë 3 mujorit të parë dhe të dytë të vitit 2021 ka sjell efekte pozitive në tregun financiar, duke ulur interesat e borxhit dhe rritur kthimin e Fondit Premium. Vazhdimi i procesit të vaksinimit masiv të popullatës, ka sjell lehtësimin e masave anti-COVID dhe hapje të metejshme të ekonomisë gjatë muajve të verës. Rritja e aktivitetit ekonomik pritet të ketë efekt pozitiv në të ardhurat e shtetit dhe në financat publike në Shqipëri, duke ulur kështu luhatshmërinë e normave të borxhit të brendshëm. Megjithatë, rritja e rasteve pozitive me COVID-19 si pasojë e përhapjes së variantit Delta kohët e fundit, pritet të sjellë kufizime të pjesshme të orareve të qarkullimit gjatë 3-mujorit të fundit të vitit, të cilat së bashku me kufizimet e vendosura nga vendet e rajonit mund të impaktojnë ecurinë e treguesve ekonomik dhe fiskal.

Çmimi i Kuotës



Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë www.credinsinvest.com.